

**STATUTI I SHOQERISE  
“DRITONISLAMI” Sh.p.k**

Ne kete statut

- "Ligji" eshte Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare";
- "Statuti" eshte Statuti i shoqerise;

**Kreu I**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia**

**Neni 1:**

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

(1) Sot, me **12/04/2022** une, themeluesi, kam krijuar nje shoqeri me perqegjesi te kufizuar me emrin "**DRITONISLAMI**" SH.P.K.

(2) Themeluesi i shoqërisë eshte:

**Z.DRITON HOXHA**, shtetas kosovar, lindur më 07.04.1979 në Bellanicë, Kosovë, identifikuar me nr identifikimi 1500282793, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar.

**Neni 2:  
Objekti**

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e me poshtem:

Ajgent burse (broker)

**Neni 3:  
Kohezgjatja**

Kohezgjatja e shoqerise do te jetë pa afat.

**Neni 4:  
Selia**

Selia e shoqerise ndodhet ne adresen: Tiranë , Rruga e "Kavajës", Pallati Nr.98, Shkalla 2, Ap.32, Njësia Administrative Nr.7, Tiranë.

**Kreu II Kapitali**

**Neni 5  
Kapitali themeltar**

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 10.000 (dhjete mijë) leke dhe nuk eshte paguar, i perbere nga nje kuote me vlore nominale 10.000 (dhjete mijë) leke.

Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte si me poshte:

Z.DRITON HOXHA, shtetas kosovar, lindur më 07.04.1979 në Bellanicë, Kosovë, identifikuar me nr identifikimi 1500282793, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar i cili zoteron 100% te



kapitalit.

#### Neni 6:

##### Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimave te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kereses se administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejen mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

#### Neni 7

##### Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me perjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashegimisse;
- 5) dhurimit;
- d) cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

### KREU III

#### ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

##### Neni 8

##### Organji Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e perjithshme e ortakeve eshte perjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme: a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;

- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- 5) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendor ne shkronjat "c" dhe "5" te kesaj pike;
- dh) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire perqatjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- f) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

- g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- i) ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e per gjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete.

Administratori i shoqerise nuk mund te veprojne si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e per gjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se per gjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

#### Neni 9

#### **Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme**

Asambleja e per gjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permboj vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuari per mbledhjen e asamblese.

Kur asambleja e per gjithshme nuk eshte thirrur si me siper, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsise.

#### Neni 10

#### **Kuorumi**

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkonje nje shumice te zakonshme, asambleja e per gjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e per gjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkonje shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese asambleja e per gjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit te permendor me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

#### Neni 11

#### **Marrja e vendimeve**

Asambleja e per gjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndaijen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e per gjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si:

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- d) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire per gatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- f) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

## **Neni12** **Perjashtimi nga e drejta e votes**

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e per gjithshme merr vendim per:


- a) vleresimin e veprimtarise se tij;
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
- c) ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria;
- d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaquesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

## **Neni13** **Administrimi**

13.1 Personi i me poshtem caktohet si Administrator i pare i shoqerise:

**Z.DRITON HOXHA**, shtetas kosovar, lindur më 07.04.1979 në Bellanicë, Kosovë, identifikuar me nr identifikimi 1500282793, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar i cili emerohet per nje periudhe 5 (pese) vjecare

Nenshkrimi i administratorit 

## **Neni14** **Kompetencat e Administratoreve**

Administratori kane te drejte e detyrohet te:

- a) kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e per gjithshme;
- b) perfaqesoje shoqerine tregtare;
- c) kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- ç) pergatit dhe nenshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se per gjithshme per miratim;
- d) krijon nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rr Ethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- dh) kryen regjistrimet dhe dergon te dhenat e detyrueshme te shoqerise, si parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Registrimit;
- e) raporton perpara asamblese se per gjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- e) kryen detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

## **Neni15** **Pergjegjesite e Administratorit**

Administratori eshte per gjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojet e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojet perkatese.

Pavec sa eshte parashikuar ne dispozitat e per gjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

- a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te



mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis;

b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;

c) te vleresoje me perjegjesi ceshtjet, per te cilat merret vendim;

c) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise;

d) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.

#### **Kreu IV** **Viti finansiar**

##### **Neni16**

###### **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

#### **Kreu V** **Prishja-riorganizimi i shoqerise**

##### **Neni17**

###### **Prishja dhe likuidimi**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a) me vendim te Asamblese se Ortakeve;
- b) me hapjen e procedurave te falimentimit;

#### **Neni18** **Riorganizmi i shoqerise bashkimi-ndarja**

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare."

##### **Neni 19**

###### **Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

##### **Neni 20**

###### **Mosmarreveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare e Rrethit Gjyqesor Tirane.

##### **NENI 21** **Kopjet**

Ky dokument redaktohet ne 3 (tre) kopje originale.

Lexuar, kuptuar, aprovuar e nenshkruar nga ortaku themelues.

***ORTAKU THEMELUES***

**Z.DRITON HOXHA**

A handwritten signature in black ink, appearing to read "DH!" followed by a stylized surname.